



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A
DREJTORIA LIGJORE

Tiranë, më 18.12.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje SMS, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 2(dy) vite”.

VLERA E FONDIT LIMIT: 15,000.000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, pa TVSH.

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbimet e mesazheve (sms), 64216000-3**

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), nenit 76.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Afati i shërbimit i kësaj platforme elektronike për blerjen e SMS-ve do të jetë 24 muaj kalendarikë, deri në ezaurimin e 2,800,000 (dy milionë e tetëqind mijë) krediteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor duke filluar nga momenti i implementimit të automatizimit të njoftimit të sms-ve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3,

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të madhe se 40% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar). Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të

kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të furnizimeve/shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë, në një vlerë jo më e madhe se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore ..., të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatën përkatëse të vlefshme ISO në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit (‘DPA’) ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) Standardin **ISO 9001:2015** ose ekuivalente (e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë.

b) Standardin **ISO 27001:2022** ose ekuivalente (e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

c) Standardin **ISO 20000-1:2018** ose ekuivalente (e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ofertues në këtë procedurë, secili prej operatoreve ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata “ISO” të rënditura më lart, sipas zërave të shërbimeve/mallrave, që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt marrëveshjes midis palëve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

c) **Certifikimi ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

d) **Certifikimi ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë, të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesit të këto sisteme të

jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do të ketë vijim të mirëmbajtjes dhe garancisë së suportit të të dy sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike, për atë sa ekspozohen sistemet në fjalë.

- e) **Certifikimi ISO 20001-1:2018** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të dy sistemet që kërkojnë në DST, të cilët janë tërësisht të bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.3.3 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit, duhet të përmbushë minimalisht kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin tekniko-profesional staf të certifikuar si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinierë Telekomunikacioni/Elektronik ose Informatikë, me diplomë përkatëse;
- b. 1 (një) punonjës të certifikuar për rrjetat e të dhënave, në nivel profesional;
- c. 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për data base;
- d. 1 (një) punonjës të certifikuar për IT Infrastructure Service Management ITIL ose ekuivalent.

- Platforma e cila do të përdoret për këtë sistem duhet që të ketë kaluar me sukses Penetration Test për shërbimet që ofron. E vërtetuar me raportin/faturën përkatëse.

(Sqarim: lidhur me certifikimet një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim të kërkuar për të përmbushur kriterin)

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

- a. *1(një) Inxhinierë Telekomunikacioni/Elektronik ose Informatikë, me diplomat përkatëse:*

Argumentimi: Germa A) Këta specialistë janë të domosdoshëm për administrimin e përgjithshëm teknik të platformës SMS, integrimin e saj me sistemet e institucionit, monitorimin e trafikut, si dhe marrjen e masave të menjëhershme në rast avarie. Profesionistët e këtyre profileve zotërojnë njohuri mbi arkitekturën e rrjeteve, protokollet e komunikimit dhe ndërveprimin me sistemet e operatorëve celularë, të cilat janë baza e funksionimit të shërbimit SMS.

- b. *1 (një) punonjës të certifikuar për rrjetat e të dhënave, në nivel profesional;*

Argumentimi : Gërma B) Ky profil është thelbësor për konfigurimin dhe administrimin e rrjetit të të dhënave mbi të cilin funksionon platforma SMS. Specialistët në nivel profesional garantojnë stabilitetin e komunikimit ndërmjet serverëve dhe rrjeteve të operatorëve celularë, minimizimin e vonesave, shmangien e bllokimeve të trafikut dhe administrimin e sigurisë rrjetore. Funksionimi i pandërprerë i këtij rrjeti është i domosdoshëm për vijueshmërinë e shërbimit

- c. *1 një punonjës të certifikuar në nivel profesional për data base;*

Argumentimi: Gërma C) Platformat SMS përpunojnë sasi të konsiderueshme të dhënash, si lista kontaktesh, regjistra komunikimi dhe log-e teknike. Një specialist i databazave garanton integritetin e të dhënave, performancën e sistemeve të ruajtjes, procedurat korrekte të backup-it, rikuperimin në raste emergjencash dhe menaxhimin e aksesit ndaj informacionit. Ky rol është i domosdoshëm për të shmangur humbje, dëmtime ose moskoherencë të të dhënave teknike.

- d. *1 (një) punonjës të certifikuar për IT Infrastructure Service Management ITIL ose ekuivalent.*

Argumentimi: Gërma D) Ky rol siguron që operatori ekonomik ka procese të standardizuara për menaxhimin e shërbimit IT, trajtimin e incidenteve, ndryshimeve, problematikave teknike dhe raportimit të performancës. Zbatimi i praktikave ITIL është i domosdoshëm për garantimin e cilësisë operationale të platformës dhe për mbajtjen nën kontroll të të gjithë ciklit të menaxhimit të shërbimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4 paragrafi a), b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Kriteret e kualifikimit janë vendosur në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës me qëllim që të vërtetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet ligjore dhe kualifikimet e nevojshme

teknike e profesionale si edhe pervojën e duhur për përmbushjen me sukses të kontratës, objekt i këtij prokurimi, e cila ka një specifikë të veçantë .

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për **“Blerje SMS, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 2(dy) vite”**, janë hartuar mbi bazën e **Urdhrit Nr. 05**, datë **10.02.2025**, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit **nr. 12**, datë **28.02.2025**, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76.

“Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 **“Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”**, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlllogaritur vlerën limit të kontratës.

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT